

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data: **20.07.2015**

Për: Operatorin ekonomik “Alb Garden” sh.p.k, me NIPT K37513520N.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur” me objekt “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohëshme, segmenti rrugor Lushnje-Berat, Lot 3”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohëshme, segmenti rrugor Lushnje-Berat, Lot 3”.**

Kohëzgjatja: **3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **32,660,099 (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë (pa TVSH).**

Burimi i financimit: **Buxheti i Shtetit.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 15.06.2015.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Nuk ka patur.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	OPERATORI EKONOMIK	OFERTA
1.	Alb Garden	31,884,005
2.	Fusha	32,421,150
3.	Garden Line	32,660,096
4.	Caushi	Nuk ka paraqitur oferte
5.	Kajmaku	Nuk ka paraqitur oferte

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Shoqëria “Fusha” sh.p.k.**
2. **Shoqëria “Garden Line” sh.p.k.**
3. **Shoqëria “Çaushi” sh.p.k.**

4. **Shoqëria “Kajmaku” sh.p.k.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. **Shoqëria “Fusha” sh.p.k.**

Nuk plotëson kërkesën 2.4.6 të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit (disponimin e mjeteve) pasi ka paraqitur dokumentacion vetëm për një mjet transporti vetëshkarkues me kapacitet mbajtes minimal 20 ton. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se vetëm mjeti me targë AA337GC e plotëson kushtin, ndërsa mjetet e tjerë të deklaruar në shtojcën 9 nuk e plotësojnë atë. Konkretisht mjeti me targë TR7702I i deklaruar me kapacitet 20 ton, sipas lejes së qarkullimit ka peshën me ngarkesë 32.000 kg, peshën pa ngarkesë 14.800 kg dhe si rrjedhim kapaciteti mbajtes rezulton 17,2 ton, pra me i ulët se ai i kërkuar. Po ashtu mjeti me targë TR1248T i deklaruar me kapacitet 20 ton, sipas lejes së qarkullimit ka peshën me ngarkesë 32.000 kg, peshën pa ngarkesë 16.200 kg dhe si rrjedhim kapaciteti mbajtes rezulton 15,8 ton, pra më e ulët se ai i kërkuar.

2. **Shoqëria “Garden Line” sh.p.k.**

Nuk plotëson kërkesën 3.5 të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit (disponimin e një objekti mbështetës) pasi kërkesa në mënyrë shumë të qartë kërkon që operatori ekonomik të paraqesë dokumentacionin e pronësisë ose të qiramarrjes së këtij objekti. Faktikisht kjo shoqëri ka paraqitur një leje ndërtimi të datës 27.01.2003, për shoqërinë ndërtuese “Garden Line” sh.p.k, lëshuar në emër të z. Klod Zigori si dhe një Leje shfrytëzimi që i jep zotit Klod Zigori të drejtën e shfrytëzimit të kompleksit të serrave. Këto dokumente në vetvehte nuk përbëjnë as vërtetim pronësie për shoqërinë “Garden Line” sh.p.k. dhe as dokument qeramarrje nga kjo shoqëri. Në këtë mënyrë komisioni gjykon se ky kusht nuk plotësohet.

1. **Shoqëria “Caushi” sh.p.k. për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.**

2. Shoqëria “Kajmaku” sh.p.k. për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Alb Garden” sh.p.k, me NIPT K37513520N se oferta e paraqitur, me vlerë 31,884,005 (tridhjetë e një milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesë) Lekë (pa TVSH) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, (Fondi Shqiptar i Zhvillimit), Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet

ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **09.07.2015**.

Ankesa: Nuk ka patur.

